

ÇËSHTJET E REFORMËS NË SISTEMIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

Mr.sc Rafet Haxhaj*

Abstrakt:

Reformimin e gjyqësorit si proces të domosdoshëm e determinuan ndryshimet shoqërore, ekonomike e politike që u bënë në Kosovë. Këto ndryshime shënuan jo vetëm fundin e një regjimi komunist, por edhe ndarjen nga juridiksioni i ish Jugosllavisë dhe Serbisë dhe hyrjen e Kosovës në tranzicion të vështirë drejt sistemit demokratik, pluralist dhe ekonomisë së tregut të lirë. Sistemi Gjyqësor që u ndërtua menjëherë pas luftës përmbante në vete edhe një pjesë të sistemit të kaluar si nga organizimi i gjykatave, procesit të punës në to e po ashtu edhe normat ligjore të së kaluarës dhe me të gjitha këto edhe mentalitetin e vjetër juridik. Çështja e pazgjidhur e statusit final të Kosovës bëri që për një kohë të këtë zvarritje në fillimin e reformës së gjyqësorit. Ndarja e kompetencave lidhur me administrimin e gjyqësorit në mes të Departamentit të Drejtësisë (Shtylla e Parë e UNMIK-ut), Departamentit të Administratës Gjyqësore që për një kohë ishte në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike e më vonë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me Përfaqësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) si autoritet i fundit, nuk dhanë rezultatet e pritura se me në fund reforma në gjyqësor do të fillojë dhe se çështjet do të merrnin kahun e zgjidhjes së tyre. Figura e gjykatësit e cila kudo në botë është figurë e respektuar, në Kosovën nën administrimin e Misionit të Kombeve të Bashkuara u degrada në atë masë, sa që, ishte shumë herë më e dobët se një përkthyes i thjeshtë UNMIK-u apo OSBE-je, ose e një punëtori të administratës në ndërmarrjet publike. Në nivelin organizativ kaluan plot tetë vite pas instalimit të Misionit të mbikqyrjes ndërkombëtare në Kosovë dhe edhe më tutje nuk është bërë nxjerrja e Ligjit për Gjykatat dhe e një rregulloreje për organizimin e veprimtarisë së brendshme të tyre. Gjykatat “vuajnë” edhe më tutje nga shumë punë që bien në fushëveprimtarinë e funksionit të noterisë, sektorit të punëve të brendshme, të administratës lokale etj. Gjyqësorit në

* Mr.sc Rafet Haxhaj, Gjykatës në Gjykatën Komunale në Klinë- Kosovë, dhe kryeredaktor i Buletinit të Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës. Opinionet e shprehura në këtë artikull janë vetëm të autorit dhe nuk shprehin qëndrimin e organizatës për të cilën ai punon.

Kosovë i nevojitet një reformë edhe në aspektin ligjor. Nxjerrja e Kodeve të reja penale (Kodit Penal dhe atij të procedurës), Ligjit për Familjen, Ligjit për Trashëgimin etj sikur kanë freskuar strukturën ligjore në Kosovë, megjithatë mbetet edhe shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim. Nevoja e angazhimit të të rinjve në gjyqësorin e Kosovës, organizimi i mësimit klinik për studentët e drejtësisë dhe përmirësimi në shkallë vendi në aspektin e shkrimit ligjor si dhe hapja e një shkolle të magjistraturës mbetën disa nga sfidat e gjyqësorit të Kosovës në të ardhmen.

Fjalët kyç: *Reformë, Sistem Gjyqësor, kompetencë, mision, mësim klinik, Shkollë e Magjistraturës.*